
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05Nr.391/02-96999/24 dt.25.07.2024, të kërkesve/bashkëpronarit, NPT “Agro-Trade” shpk, me seli në Graçanicë, magjistranja Prishtinë-Shkup, dhe Investitori NPT “Agro-Trade” shpk, me seli në Graçanicë, magjistranja Prishtinë-Shkup, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810502535 dhe me pronar Sadudin Humolli nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin, me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “ATG 1”, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “A16”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rr. “Agron Rrahmani” dhe “Andrea Aleksi” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 13.09.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkesve / bashkëpronarit, NPT “Agro-Trade” shpk, me seli në Graçanicë, magjistranja Prishtinë-Shkup, dhe Investitorit NPT “Agro-Trade” shpk, me seli në Graçanicë, magjistranja Prishtinë-Shkup, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810502535 dhe me pronar Sadudin Humolli nga Prishtina, sipas kërkesës 05Nr.391/02-189119/24 dt.19.01.2021, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa “ATG 1”, me etazhitet 2B+S+P+11, e ndërtuar sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit”, 05Nr.351/02-179522/19 dt.25.09.2019, në emër të NPT “Agro-Trade” shpk, dhe Shehize Alidemi, e lëshuar nga kjo drejtori, në parcelën kadastrale nr. 1695-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-01695-0, ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urban “A16”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Agron Rrahmani” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 107, 109, 111, 113, 115, 117, 135, 137, 139, 125, 123, 121, 119, 133, 129, dhe 127, dhe në rrugën “Agron Rrahmani” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 107, në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkesit / bashkëpronari, NPT “Agro-Trade” shpk, me seli në Graçanicë, magjistranja Prishtinë-Shkup, dhe Investitorit NPT “Agro-Trade” shpk, me seli në Graçanicë, magjistranja Prishtinë-Shkup, me certifikatë të regjistrimit të biznesit ARBK 810502535 dhe me pronar Sadudin Humolli nga Prishtina, me kërkesën me 05Nr.391/02-189119/24 dt.19.01.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin, me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht Ndërtesa

“ATG 1”, me etazhitet 2B+S+P+11, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “A16”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1695-0, ZK Matiçan, ndërtuar sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit”, 05Nr.351/02-179522/19 dt. 25.09.2019, në emër NPT “Agro-Trade” shpk, dhe Shehize Alidemi, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-82025/24 dt. 23.07.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Isa Nasufi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Mentor Kryeziu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Armend Kastrati; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Mevlan Ramadani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Edita Gashi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Agon Blakaj me nr. të licensës 205;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimet e makineris, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në dëshminë e pronësisë për parcelën kadastrale nr. 1695-0 ZK Matiçan, pronarë/posedues të kësaj parcele kadastrale është NPT “Agro-Trade” shpk, përderisa posedues të lejes ndërtimore janë bashkëpronarët: NPT “Agro-Trade” shpk, dhe Shehize Alidemi. Në ndërkohë, bazuar në aktin noterial “Kontratë për shitëblerejen e palujtshmërisë: Truallit me qirambajtje për 98 vite”, i përpiluar te Noteri Isak Ademi, në Prishtinë, me Nr. LRP-së.6136/2019 dhe Nr. REF.1872/2019, të datës 15.04.2021, pronarë të parcelës kadastrale nr. 1695-0, ZK Prishtinë, është vetëm N NPT “Agro-Trade” shpk, dhe rrejdhimisht certifikata e përdorimit lëshohet në emër të të njëjtit.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.



Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-96999/24 DT. 13.09.2024**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu



